

## **VENDIM**

**Nr. 253, date 18.5.2000**

### **PER ORGANIZIMIN E SHERBIMIT TE KONTROLLIT TE PLEHRAVE KIMIKE**

Ne mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6,7 dhe 20, të ligjit nr.8531, datë 23.9.1999, «Per Sherbimin e Kontrollit të Plehrave Kimike», me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Ushqimit, Keshi»i i Ministrave

#### **V E N D O S I:**

1. Sherbimi i Kontrollit të Plehrave Kimike është pjesë e strukture, organizative të Institutit të Tokave dhe perbehet nga administratoret, inspektorët dhe punonjësit ndihmes.

2. Administratoret, inspektorët dhe punonjësit ndihmes emerohen nga keshilli drejtues i Institutit të Studimit të Tokave, me propozimin e drjtorit të ketij institucioni.

3. Numri i punonjësve të Sherbimit të Kontrollit të Plehrave Kimike të jete 9(nente) administratore, 5 (pese) inspektore dhe 3 (tre) punonjes ndihmes.

4. Paga e administratoreve caktohet ne baze te vendimit nr.393 , date 3.9.1992, te Keshillit te Ministrave, «Per pagat e punonjësve te institucioneve buxhetore», pika 4, paragrafet 1 dhe 2. Fondi per pagat perballohet nga buxheti i vitit 2000, i miratuar per Ministrine e Bujqësisë dhe Ushqimit.

5. Paga e inspektoreve dhe punonjësve ndihmes vendoset nga keshilli drejtues i Institutit të Studimit të Tokave, ne raport me te ardhurat qe krijohen gjate veprimtarise se Sherbimit te Kontrollit te Plehrave Kimike.

6. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Instituti i Studimit të Tokave per zbatimin e ketij vendimi.

Ky vendim hyn ne fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Ilir Meta**